

Gjendja e Ujërave në Kosovë

- Analizë e situatës së ujërave
në Mitrovicë -

SHKURTESAT

IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
KNU	Këshilli ndër-ministros i Ujërave
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Ujërave
AMMK	Agjencioni i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
ME	Ministria e Ekonomisë
NJPM	Njësia për Monitorim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ARPL	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
KRU	Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit
SHUKOS	Shoqata e Ujësjetësimit dhe Kanalizimeve të Kosovës
QRSHP	Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike

Përmbajtja

Shkurtesat	2
HYRJE	4
E DREJTA PËR UJË	5
2.1. e DREJTA NDËRKOMBËTARE	5
GJENDJA E RESURSEVE UJORE NË KOSOVË	8
3.1 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	8
3.1.2. STRATEGJIA KOMBËTARE E UJËRAVE TË KOSOVËS 2017-2036	8
2. LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS	9
CILËSIA E UJËRAVE	12
Cilësia e ujit të pijës	12
Cilësia e ujit për pije në Kosovë	13
GJENDJA E RESURSEVE UJORE NË MITROVICË	14
Pellgu i Lumit Ibër	14
CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM NË REGJIONIN E MITROVICËS	16
Cilësia e ujit të pijes e cila kontrollohet nga IKSHPK	16
Gjendja e pellgut lumor- IBËR	19
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	24

HYRJE

Projekti “Healthier Kosovo 2” Implementohet nga 7 Arte dhe financohet nga zyra e UNDP-së në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të avokoj për mbrojtjen e lumenjëve të Kosovës me theks të veçantë të lumenjëve të Mitrovicës për zbatimin, menaxhimin dhe përdorimin efikas dhe të qëndrueshëm të resurseve ujore, duke balancuar interesat konfliktuoze në menaxhimin e ujërave. Ky projekt po ashtu synon të ndërtojë kapacitete afatgjata për mbrojtje të resurseve ujore, në përputhje me nevojat për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Ky raport prezanton gjetjet e analizës së kornizës ligjore dhe identifikimit të mangësive në zbatim në lidhje me pjesëmarrjen e akterëve, duke përfshirë nevojat prospektive për pajtueshmëri me Direktivën Kornizë të Ujërave, si dhe një analizë të thuktë të kornizave rregullative kombëtare.

Tutje, ky raport ofron një analizë të detajuar të përshkimeve ligjore që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore, duke filluar nga e drejta ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar që zbatohet në lidhje me ujërat. Ky raport përmbanë një përshkrim të kujdesshëm të të drejtave të përcaktuara nga traktatet dhe rregulloret ndërkombëtare, konventat si dhe marrëveshjet e nënshkruara nga Republika e Kosovës për menaxhim të ujërave.

Po ashtu, raporti ofron një vlerësim të situatës së ujërave në rajonin e Mitrovicës, duke përfshirë matjet e cilësisë së ujrave, gjendjen aktuale të resurseve ujore dhe ndikimet e faktorëve të ndryshëm në këtë zonë. Raporti mund të referohet si një analizë në të cilën janë përfshirë aspekte të cilësisë së ujërave, disponueshmërisë së tyre dhe ndikimet e ndotjes në ta, duke përfshirë edhe ndikimin e veprimtarive industriale dhe mjedisore.

Në fund të raportit, janë paraqitur rekomandime konkrete për akterët e ndryshëm të përfshirë në menaxhimin e ujërave në zonën e Mitrovicës duke synuar që të promovojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore e lokale, organizatave jo-qeveritare dhe komuniteteve të Kosovës në përmirësimin e menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjen e burimeve ujore në rajonin e Mitrovicës.

E DREJTA PËR UJË

E drejta për ujë është një prej të drejtave themelore të njeriut, e cila përfshin të drejtën e çdo personi për qasje në ujë të pastër, të sigurtë dhe të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat themelore të përditshme. Por nuk duhet harruar se uji është më shumë se një burim jetësor; ai është themel për jetën dhe shëndetin e të gjithë njerëzve. E drejta për ujë përfshin edhe të drejtën e njerëzve për të marrë informata dhe për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me menaxhimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

Shtetet janë përgjegjese për të siguruar zbatimin e e drejtës për ujë. Kjo përfshin zhvillimin e politikave dhe legjislacionit të nevojshëm për të garantuar që uji të jetë i qasshëm dhe i sigurt për të gjithë. Investimet në infrastrukturë ujore, monitorimi i cilësisë së ujit dhe trajtimi i ndotjes janë disa nga hapat kryesorë që shtetet duhet të ndërmarrin për to ofruar garanci tek qytetarët e tyre për ujin e pijes.

2.1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE

Të drejtat ndërkombëtare për ujë të pijes paraqesin një aspekt themelor të mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut. Në rastin e Kosovës, ku gjendja politike dhe statusi ndërkombëtar ndonjëherë kanë bërë të vështirë anëtarësimin në konventa ndërkombëtare, kjo çështje është po aq e rëndësishme sa dhe për çdo tjetër vend. E drejta për akses në ujë të pastër dhe sigurtë për t'u pezulluar është kritike për shëndetin dhe mirqënien e qytetarëve.

Fillimisht është e rëndësishme të theksohet se për shkak të situatës së përgjithshme politike dhe statusit të njohjes ndërkombëtare si shtet i pavarur, Kosova nuk është anëtare e konventave të ndryshme ndërkombëtare që mbrojnë dhe përfaqësojnë të drejtat universale të ujit të pijes dhe si rrjedhojë është zyrtarisht e kufizuar në zbatimin e këtyre akteve ligjore. Megjithatë, Akti Kushtetues i Kosovës rregullon mënyrën e ratifikimit dhe statusin juridik të traktateve ndërkombëtare në sistemin e përgjithshëm juridik të vendit. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pas publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen drejtpërdrejt me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetë-zbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.

Sistemi i njeh obligimet ndërkombëtare të Kosovës dhe garanton që instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara do të kenë fuqi ligjore më të lartë se instrumentet ligjore vendore¹. Akti Kushtetues

¹ Sipas Aktit Kushtetues të Kosovës, Neni 19 [Zbatueshmëria e së Drejtës Ndërkombëtare], marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht detyruese të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

gjithashtu rregullon në detaje procedurën e nënshkrimit dhe ratifikimit të traktateve ndërkombëtare.

Përveç akteve kushtetuese që egzistojnë dhe zbatohen në Kosovë, vendin e përfshijnë edhe obligimet e tjera që dalin nga aktet ligjore të shteteve fqiznjë meqenësë të gjithë lumenjtë kryesor të Kosovës (Ibri, Morava e Binçës, Lepenci, Plava dhe Drini i Bardhë) janë ndërkufitarë dhe u takojnë pellgjeve të tre lumenjëve të cilët derdhen në 3 dete – pellgut të Drinit që derdhet në Detin Adriatik, pellgut të Danubit që derdhet në Detin e Zi, dhe pellgut të Vardarit që derdhet në Detin Egje. Bashkëpunimi me këto vende në fushën e ujërave në frymën e parimeve të së drejtës ndërkombëtare është me interes për Kosovën. Përpos çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me cilësinë e ujërave dhe zbatimin e parimit të mosdëmtimit, çështjet specifike që duhet të merren në konsideratë sa i përket zbatimit të së drejtës ndërkombëtare ujqore në rastin e Kosovës janë:

-Në pellgun e Danubit ku hyjnë lumenjtë Ibri dhe Morava e Binçës me degët e tyre të cilat rrjedhin prej Kosovës në Serbi – si çështje potenciale mund të paraqiten liqeni i Ujmanit (edhe pse objektivisht nu ka bazë për të), dhe çështje tjetër mundë të jetë ndotja e lumenjve;

-Në pellgun e Vardarit ku hyn lumi Lepenc i cili rrjedh nga Kosova në Maqedoni – si çështje potenciale ku duhet të aplikohet e drejta ndërkombëtare për ujëra mund të paraqitet hidrosistemi i planifikuar Lepenci në Kosovë, si dhe ndotja e lumenjve;

-Në pellgun e Drinit ku hyn lumi Drini Bardhë me degët e tij që rrjedh prej Kosovës në Shqipëri si çështje potenciale ku duhet të aplikohet e drejta ndërkombëtare për ujëra mund të paraqitet hidrocentrali i planifikuar i Zhurit, si dhe ndotja e ujërave.

Ligjshmëria e Bashkimit Europian (BE) për ujërat përfshin direktivat që janë akte ligjore që përcaktojnë qëllimet që shtetet anëtare duhet të realizojnë. Ky kompleks i legjislacionit njihet si *acquis*. Për mënyrën se si këto qëllime do të realizohen, vendet anëtare kanë për të detyrë të hartojnë ligje në nivelin nacional në mënyrë që të i arrijnë qëllimet e tyre.

Janë një numër i konsiderueshëm i direktivave të BE-së të cilat e përbëjnë kornizën ligjore në fushën e ujërave:

- o Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 për krijimin e një kornize për veprim në Komunitet në fushën e politikave të ujërave (OJ L 327, 22.12.2000, f. 1), i ndryshuar së fundmi me Direktivën 2009 /31/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 prillit 2009; Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e 21 majit 1991 në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza në zona urbane (OJ L 135, 30.5.1991, f. 40), e ndryshuar së fundi nga Rregullorja (KE) Nr. 1137/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 tetorit 2008;
- o Direktiva e Këshillit 98/83/EC e datës 3 nëntor 1998 mbi cilësinë e ujërave të destinuar për konsum njerëzor (OJ L 330, 5.12.1998, f. 32), e ndryshuar së fundi nga Rregullorja (KE) Nr. 596/2009 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 qershorit 2009;

- o Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e datës 12 dhjetor 1991 në lidhje me mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e burimeve bujqësore (OJ L 375, 31.12.1991, f. 1), e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (EC) Nr. 1137/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 22 tetorit 2008;
- o Direktiva e Këshillit 80/68/EEC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja e shkaktuar nga disa substanca të rrezikshme (OJ L 20, 17.12.79), e ndryshuar nga Direktiva e Këshillit 91/692/EEC e 23 dhjetorit 1991 që standardizon dhe justifikon raportet mbi zbatimin - dhënien e direktivave specifike në lidhje me mjedisin (OJ L 377, 31.12.1991);
- o Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2006 për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi (OJ L 372, 27.12.2006, f. 19-31);
- o Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shkurt 2006 lidhur me menaxhimin e cilësisë së ujërave për pastrim;
- o Direktiva 2006/11/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shkurt 2006 mbi ndotjen e shkaktuar nga substanca të caktuara të rrezikshme që shkarkohen në mjedisin ujor të Komunitetit (versioni i kodifikuar i Direktivës së Këshillit 76/464/EEC dhe amendamentet e saj) (OJ L 64, 4.3.2006);
- o Direktiva 2006/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 shtatorit 2006 mbi cilësinë e ujërave të ëmbla që kanë nevojë për mbrojtje ose bonifikim për të mbështetur jetën e peshqve (OJ L 264, 25.9.2006) (versioni i kodifikuar që zëvendëson dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 78/ 659/EEC për cilësinë e ujërave të ëmbla që kanë nevojë për mbrojtje ose bonifikim për të mbështetur jetën e peshqve);
- o Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet (OJ L 288, 6.11.2007).

GJENDJA E RESURSEVE UJORE NË KOSOVË

3.1 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Pas vitit 1999, Republika e Kosovës ka zhvilluar një legjislacion të ri për menaxhimin e ujërave dhe për shërbimet e ujit, në përputhje me avansimin dhe modernizimin e vendit. Përveç ligjeve që direkt kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave, ekzistojnë edhe lidhje të rëndësishme me sektorin e mjedisit dhe legjislacionin horizontal, që kanë ndikim në institucionet dhe procedurat në fushën e menaxhimit të ujërave.

Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në miratimin e një legjislacioni modern për menaxhimin e ujërave. Ky progres është stimuluar nga synimi i vendit për të harmonizuar ligjet e saj me ato të Bashkimit Europian (BE), duke synuar eventualisht integrimin në BE. Shumica e direktivave të BE-së në lidhje me ujin janë të inkuorporuara në legjislacionin e Kosovës.

Në kuadrin ligjor që rregullon drejtpërdrejt menaxhimin e burimeve ujore dhe shërbimet ujore, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me resurset ujore dhe shërbimet ujore, përfshihen ligjet si më poshtë:

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat, i miratuar në vitin 2013, është një instrument themelor ligjor që rregullon menaxhimin e ujërave dhe të drejtat ujore. Ligji i integron shumicën e standardeve dhe parimeve nga DKU në sistemin ligjor të Kosovës, duke rregulluar politikën e ujërave.

3.1.2. STRATEGJIA KOMBËTARE E UJËRAVE TË KOSOVËS 2017-2036

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës është dokument kryesor planifikues në fushën e ujërave i hartuar në bazë të Ligjit për Ujëra për periudhë kohore 20-vjeçare. Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të sektorit të ujërave duke i plotësuar nevojat për: furnizim me ujë, ujin për prodhimin e ushqimit, ujitje dhe bujqësi, industri, prodhim të energjisë, peshkim, turizëm, sport dhe rekreacion.²

Strategjia është një dokument planifikues në bazë të të cilit promovohen reforma në sektorin e ujërave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore vendore dhe arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian (BE) përkitazi me administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujore.

Strategjia është hartuar për një afat kohor prej 20 vitesh dhe vlen për periudhën kohore të aprovuar. Strategjia aktuale është planifikuar të zbatohet në katër periudha kohore: periudha e parë do të përfshijë vitet 2017 deri më 2021, periudha e dytë 2022-2026, periudha e tretë 2027-2031 dhe periudha e katërt 2032-2036.³

² https://puacë.lidipeja.org/ep-content/uploads/2023/04/Permbledhje-Monitorimi-Strategjiise-Ujerave_FINAL_ALB.pdf

³ https://puacë.lidipeja.org/ep-content/uploads/2023/04/Monitorimi-Strategjiise-Ujerave_FINAL.pdf

2. LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës i rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me resurset ujore si dhe çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave, duke përfshirë: shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave, mbrojtjen nga ujërat etj.

Qëllimi i këtij ligji, është së pari të definojë pronësinë e resurseve ujore, të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1: “Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj”. Mirëpo ka shumë raste kur një komunë, fshat apo komunitet nuk lejon, pra kundërligjshëm, komunën, fshatin apo komunitetin fqinj të shfrytëzoj resursin ujor në territorin e tyre.

Fushëveprimi i Ligjit përfshin ‘rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.’

Pra, Ligji rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me administrimin dhe financimin e menaxhimit të resurseve ujore duke përfshirë: (i) shfrytëzimin e tyre, (ii) mbrojtjen e tyre, dhe (iii) mbrojtjen nga to. Përgjegjësitë për këtë ia delegon Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), dhe agjencisë në kuadër të saj, Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL).

Duke marrë parasysh se ligji i vjetër ishte nxjerrë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për dallim prej ligjit të parë, me ligjin e ri është definuar edhe pronësia e resurseve ujore si “pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës”. Përpos kësaj, me ligjin e ri janë përfshirë edhe disa ndryshime sa i përket kuadrit institucional.

Organet qeveritare në Kosovë ndahen në tri nivele administrative, siç tregohet në tabelën 1.

Qendrore	Rajonale	Lokale
<ul style="list-style-type: none"> • Ministritë • Agjencitë • institutet kombëtare 	<ul style="list-style-type: none"> • Kompanitë rajonale të ujit të pijshëm (në pronësi shtetërore) • Kompanitë e ujitjes (shtetërore) 	<ul style="list-style-type: none"> • Komunat • Ofruesit publikë lokalë të ujësjellësit

Tabela 1: Organet qeveritare në Kosovë

Akterët e tjerë qeveritar të identifikuar në lidhje me menaxhimin e ujërave janë:

- Këshilli Ndërministror i Ujit (KNMU),
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR),
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD),
- Ministria e Shëndetësisë / Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (MSH/IKSHPK),
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),
- Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës (MEE)
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI),
- Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU),
- Shoqata e Kompanive të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit të Kosovës (SHKUKK), dhe
- Kompanitë Rajonale të Ujërave (KRU).

Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv sipas Kushtetutës dhe ligjit. Propozon projektligje dhe ndryshime në ligjet dhe aktet ekzistuese, si dhe mund të japë mendim për projektligjet që paraqiten nga organe të tjera.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e legjislacionit mjedisor i takon MMPH-së, por ministrinë e tjera kanë gjithashtu përgjegjësi që lidhen me mjedisin (p.sh. MBPZHR, ME, MSH, etj.). Diferencimi i qartë i përgjegjësive është thelbësor për ta shmangur mbivendosjen e mandateve ndërmjet institucioneve qeveritare. Niveli i qeverisjes vendore (komunat) ka detyra specifike, si planifikimi strategjik vendor, monitorimi, inspektimi/zbatimi, regjistrimi/licensimi, mbledhja e të dhënave, raportimi dhe informimi dhe konsultimi me publikun).

- **Këshilli Ndërministror për Ujëra** (KNU) koordinon dhe mbështet institucionet përkatëse në menaxhimin e ujërave në procesin e vendimmarrjes duke harmonizuar nevojat dhe interesat e ndryshme dhe propozon masa për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e menaxhimit të resurseve në Kosovë.

Anëtarët aktualë të KNU-së përfshijnë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, si dhe përfaqësuesin e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (aktualisht në rol të koordinatorit kryesor të donatorëve në sektorin e ujërave) dhe donatorëve të tjerë aktivë në sektorin e ujërave që marrin pjesë me rotacion.

- **Ministria e Ekonomisë (ME)**

ME është Ministri trashëguese e (Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik-MZHE) që në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike i monitoron NP, përfshirë KRU-të dhe kompanitë e ujitjes. Ky monitorim bëhet përmes NJPM dhe qëllimi i tij është që të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia në operimin e NP.

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

MMPHI është themeluar ne vitin 2002 si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Infrastruktura i është shtuar në vitin 2021) dhe është përgjegjëse për planifikimin e mjedisit përfshirë resurset ujore, mbeturinat kualitetin e ajrit, menaxhimin e tokës, dhe planifikimin zhvillimor.

-Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKSHPK)

IKSHPK është institucion i Qeverisë nën kontrollin e Ministrisë së Shëndetësisë që ka përgjegjësi çështjet e shëndetit publik në Kosovë. Ai përcakton, monitoron dhe zbaton standardet e ujit të pijshëm në pajtim me Ligjin për Shëndetësinë Publike (Ligji Nr. Nr. 02/L-78) dhe UA Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor.

-Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)

ARRU është themeluar në vitin 2004 si Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina. ARRU është një rregullator ekonomik i shërbimeve të ujit.

-Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të): Kompanitë rajonale të ujit të pijshëm dhe kompanitë e ujitjes, të cilat janë në pronësi shtetërore, janë themeluar dhe funksionojnë në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Janë gjithsej gjashtë kompani rajonale të ujësjellësit dhe dy kompani të ujitjes; të gjitha janë renditur në tabelën 2⁴

Tabela 2: Kompanitë rajonale të ujit

Kompanitë rajonale të ujit	
1.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina
2.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Hidrodrini Sh.A, Pejë
3.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Hidroregjioni Jugor Sh.A, Prizren
4.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Mitrovica Sh.A, Mitrovicë
5.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Hidromorava Sh.A, Gjilan
6.	Kompania Ujësjellësi Rajonal Radoniqi Sh.A, Gjakovë
Kompanitë e ujitjes	
7.	Drini i Bardhë
8.	Radoniqi - Dukagjini

⁴ <http://kta-kosovo.org/html/index.php?module=htmlpages&func=display&pid=21>

-Komunat

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave qëndron tek komunat (Ligji për Vet-Qeverisje Lokale në Kosovë, Nr. 03/L-040). Ato e ushtrojnë këtë përgjegjësi përmes KRU-ve në bazë të marrëveshjeve të shërbimit të cilat përcaktojnë të drejtat dhe obligimet reciproke.

-Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimeve të Kosovës (SHUKOS)

SHUKOS është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2001 për të përfaqësuar interesat e ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit në Kosovë. Ajo ofron forum për shkëmbimin e informatave, përfaqëson interesat e KRU-ve dhe artikulon brengat e tyre.

- **OSHC-TË/OJQ-TË:** Akterët e shoqërisë civile në nivel qendror dhe global kanë zhvilluar kapacitete thelbësore dhe ndikim në çështje të ndryshme zhvillimore. Partneriteti me ta mund të kontribuojë në efektivitetin e ndërhyrjeve zhvillimore, veçanërisht në lidhje me grupet e margjinalizuara dhe të cenueshme.

CILËSIA E UJËRAVE

Qasja në ujin e pijshëm që është i sigurt është qenësor për shëndetin, e drejtë bazike njerëzore dhe një komponentë e politikës efektive për mbrojtje të shëndetit.

Uji i cilësisë së duhur është indikator bazë për shëndetin dhe mirëqenien e një shoqërie dhe rrjedhimisht me rëndësi thelbësore për zhvillimin e një vendi. Uji i ndotur jo vetëm që paraqet kërcënim të menjëhershëm për shëndetin e njeriut por gjithashtu ka ndikim edhe në shkallën e produktivitetit të një individi dhe kështu në performancën e përgjithshme të shoqërisë.

Përmirësimi i qasjes në ujë të sigurt për pije ofron përfitime të shumta shëndetësore. Kjo për shkak të rëndësisë së ujit për mbajtjen e higjienës dhe në anën tjetër për shkak se shumë sëmundje janë rezultat i kontaminimit të ujit të pijshëm të cilat paraqesin problem të theksuar për shëndetin e njeriut. Kategoritë më të rrezikuara nga këto lloj sëmundjesh janë foshnjat, fëmijët dhe pleqtë.

CILËSIA E UJIT TË PIJËS

Monitorimi i cilësisë së ujit për pije në Kosovë kryhet sipas Udhëzimit Administrativ 10/2021 “ Për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor”.

Neni 3 paragrafi 2.6 i UA 10/2021 ka përkufizuar se autoriteti shëndetësor në kuptim të këtij legjislacioni i referohet Qendrës së Ujit në kuadër të Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike.

Ky UA përcakton se autoriteti shëndetësor ka obligim që të sigurojë që uji i cili përdoret për konsum nga njeriu duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër dhe ti përmbushë kërkesat e cilësisë sipas këtij UA (neni 5 i UA 10/2021).

Vlerësimi i cilësisë së ujit për pije realizohet sipas Planit të Monitorimit të përputhshmërisë (neni9) i cili bazohet në ndarje të zonave të furnizimit dhe ekzaminimet laboratorike të ndarë sipas rutinave:

- R1- turbullira, klori rezidual dhe parametrat bakteriologjik,
- R2- parametrat e analizës bazike kimike
- R3- Metalet e rënda, pesticidet, TOC, THM

Zona e furnizimit me ujë është zona e definuar gjeografike brenda të cilës uji i destinuar për konsum njerëzor vjen nga një apo më shumë burime dhe cilësia e ujit mund të konsiderohet se është për afërsisht e njëjtë.

Frekuenca e marrjes së mostrave dhe analizimit të cilësisë së ujit është përcaktuar në përputhje me UA 10/2021 “Për Cilësinë e ujit për konsum njerëzor” në raport me sasinë mesatare ditore të ujit që futet në një zonë të furnizimit si dhe me numrin ekuivalent të banorëve.

Cilësia e ujit për pije në Kosovë

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësive që ka kjo Qendër për monitorim e ujit sipas UA Nr. 10/2021, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në gjithësejt 58 zona të furnizimit prej të cilave 47 zona janë të tipit I (sasia e ujit brenda ditës në zonë >1000m³) dhe 11 zona të tipit II (sasia e ujit brenda ditës në zone >100m³) të shtrira në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, është **99.16%** në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq **98.42%** në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike.

Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat për 66 334 teste të kryera gjatë vitit 2022 nga gjashtë laboratorët rajonalë të Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) dhe Qendra e Laboratorëve Testues në IKSHPK.

GJENDJA E RESURSEVE UJORE NË MITROVICË

Bazeni i lumit Ibër ndodhet në rajonin e Drenicës dhe Luginës së Kosovës, shërben për rreth 1.053.000 banorë. Ai është një prej katër baseneve të lumenjve në Kosovë dhe konsiderohet një nën-bazë, pjesë e bazës më të madhe transnacionale të Lumenjve të Danubit (DRB). Baza e lumit Ibër buron nga gjashtë burime në malet e Malit të Zi lindor, rrjedh në territorin e Malit të Zi dhe Serbisë dhe hyrë në territorin e Kosovës pranë vendbanimit Banja. Pastaj rrjedh në juglindje, merr një kthesë të ashpër majtas dhe kthehet në Mitrovicë. Nga aty, rrjedh në veri nëpër Zveçan, Laposaviq dhe Leshak. Pranë Rudnicës, nën majat e Maleve të Kopaonikut, kalojnë nga territori i Kosovës në Serbi, ku bashkohet me lumin Morava perëndimore dhe në fund rrjedh në lumën Danub dhe me të në Detin e Zi. Lumi Ibër ka një gjatësi më shumë se 270 km nga burimi deri te dalja në lumin Morava perëndimore, dhe 90 km të kësaj gjatësie ndodhen brenda territorit të Kosovës. Siperfaqja totale e kapërçimit të tij në Kosovë mbulon 4.044 km², që përbën 37% të territorit të vendit.

PELLGU I LUMIT IBËR

Lumi Ibër e ka një pellg me sipërfaqe prej 4,009⁵ km² – që është e dyta më e madhe pas pellgut të Lumit Drini i Bardhë.


Ky është pellgu me numrin më të madh të popullsisë prej 758,226 banorëve⁶ që përbën 42.7% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

⁵ Sipas *Strategjia Shtetërore për Ujëra 2017-2036* (fq. 109), miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2018.

⁶ Sipas *Vjetari Statistikor të Republikës së Kosovës 2023* - <https://askapi.rks-gov.net/Custom/d3897cdf-04b9-4167-aof3-2bd7ef842703.pdf#page=48&zoom=100,109,76>

⁷ Popullata e Ferizaj nuk është llogaritur këtu po te pellgu i Lepencit

Figura 1: Harta e pellgut të lumit Ibër



Pellgu i Lumit Ibër i ka gjithsej 18 stacione monitorimi.

Tri nga këto stacione i takojnë lumit vet Ibër: (i) stacioni i parë është në Kushtovë dhe cilësia e tij është e kënaqshme, (ii) stacioni i dytë është në dalje të qytetit pas të gjitha shkarkimeve të ujërave urbane e të tjera, të cilat ndikojnë që cilësia e ujit të jetë më e dobët në këtë stacion, dhe (iii) stacioni i tretë ndodhet në Kelmend pas puqitjes së Ibrit me lumin Sitnica i cili paraprakisht me vete përmban gjithë sasinë e ujërave të nënpellgjeve të këtij pellgu lumor. Sipas AMMK⁸, gjatë periudhës monitoruese të viteve të fundit (prej vitit 2014) nuk është vërejtur ndonjë rast për tu alarmuar.

⁸ Sipas Raporti për Gjendjen e Ujërave 2020 (fq. 57), AMMK - https://ëëë.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_ËEB.pdf

CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM NË REGJIONIN E MITROVICËS

Në Regjionin e Mitrovicës kalojnë 4 lumenjë duke filluar me:

Lumi Ibër i cili është një nga lumenjtë më të rëndësishëm të Mitrovicës. Ai fillon si një grup burimesh në Malet e Sharrit, duke krijuar një rrjedhë të bukur që kalon nëpër fushat e Mitrovicës dhe më pas vazhdon në Serbi. Në Mitrovicë, Ibëri është një burim i rëndësishëm uJOR dhe ka rëndësi të madhe për furnizimin me ujë të qytetit.

Lumi Morava e Binçës i cili buron në Malet e Sharrit dhe rrjedh në Mitrovicë, ku bashkohet me Ibërin. Ky bashkim ndodh pranë qytetit të Mitrovicës dhe krijon një rrjedhë të fuqishme ujore.

Lumi Sitnica është një tjetër lumë i rëndësishëm që kalon përmes Mitrovicës. Ai rrjedh nga Malet e Sharrit dhe kalon nëpër qytetin. Sitnica ka një rëndësi të veçantë për Mitrovicën dhe është përdorur për furnizimin me ujë dhe energji elektrike në këtë zonë.

Lumi Lepenci është një tjetër lumë i rëndësishëm që rrjedh në afërsi të Mitrovicës. Ai ka burimin në Malet e Sharrit dhe kalon nëpër disa qytete dhe fshatra në rrugën e tij drejt Detit të Zi.

Kompania përgjegjëse Mitrovica SH.A e cila furnizonë më ujë vendbanimet urbane dhe një pjesë të vendbanimeve rurale. Një pjesë e popullatës furnizimin me ujë për ekonomitë familjare shfrytëzojnë burime vetanake (puse, dhe burime tjera) të cilat nuk janë në menaxhim të kompanive regjionale si dhe as në monitorim të IKSHP.Në Mitrovicë mungon edhe trajtimi i ujërave të zeza, në bazë të raportit të AMMK-së për vitin 2020 thuhet se me përkrahjen e disa donatorëve të jashtëm janë kryer studime të fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza për shtatë qendrat rajonale, atë të regjionit të Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës, Prishtinës por që ende nuk ka ndonjë informatë mbi procesin e tanishëm për këto impiante.

CILËSIA E UJIT TË PIJES E CILA KONTROLLOHET NGA IKSHPK ⁹

Monitorimi i cilësisë së ujit për pije në Kosovë kryhet sipas Udhëzimit Administrativ 10/2021 “ Për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor”. Neni 3 paragrafi 2.6 i UA 10/2021 ka përkufizuar se autoriteti shëndetësor në kuptim të këtij legjislacioni i referohet Qendrës së Ujit në kuadër të Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike.

Ky UA përcakton se autoriteti shëndetësor ka obligim që të sigurojë që uji i cili përdoret për konsum nga njeriu duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër dhe ti përmbushë kërkesat e cilësisë sipas këtij UA (neni 5 i UA 10/2021).

⁹ RAPORTI VJETOR I DEPARTAMENTIT TË EKOLOGJISË HUMANE PËR VITIN 2022

Vlerësimi i cilësisë së ujit për pije realizohet sipas Planit të Monitorimit të përputhshmërisë (neni9) i cili bazohet në ndarje të zonave të furnizimit dhe ekzaminimet laboratorike të ndarë sipas rutinave:

R1- turbullira, klori rezidual dhe parametrat bakteriologjik,

R2- parametrat e analizës bazike kimike

R3- Metalet e rënda, pesticidet, TOC, THM

Zona e furnizimit me ujë është zona e definuar gjeografike brenda të cilës uji i destinuar për konsum njerëzor vjen nga një apo më shumë burime dhe cilësia e ujit mund të konsiderohet se është përafërsisht e njëjtë.

Frekuenca e marrjes së mostrave dhe analizimit të cilësisë së ujit është përcaktuar në përputhje me UA 10/2021 “Për Cilësinë e ujit për konsum njerëzor” në raport me sasinë mesatare ditore të ujit që futet në një zonë të furnizimit si dhe me numrin ekvivalent të banorëve.

Bazuar në UA 10/2021 në KRU “Mitrovica” janë identifikuar gjithsej 4 zona të furnizimit që mbulojnë 68 vendbanime në përafërsisht 155.000 banorë (ASK-2020):

1. ZF-MI-01-Shipol - (100% qyteti Mitrovica e Jugut dhe vendbanimet e zones)
2. ZF-MI-02-Shipol- (100 qyteti i Skenderajit dhe vendbanimet e zones)
3. ZF-MI-03 -Balince-(qyteti i Vushtrrise dhe vendbanimet e zones)
4. ZF-MI-04-Shipol-(Mitrovica Veriore)

Në regionin e Mitrovicës për monitorim të përputhshmërisë të cilësisë së ujit për pije sipas UA 10/2021 gjatë vitit 2022 janë testuar 1223 mostra nga ujësjellësit qendror dhe lokal, prej tyre 55 ose 1.65 % kanë rezultuar jashtë standardit për ujin për pije.(tab.nr 9)

Për monitorimin operacional të KRU “Mitrovica, ekzaminime sipas kontrates, gjithsej janë testuar 365 mostra të ujit për pije dhe 17 mostra (4.77%) e tyre kanë rezultuar të jenë jashtë standardit për ujin për pije si rezultat i mungesës së klorit rezidual , vlerave të larta të turbullirës NO₂ dhe NH₄ (tab.nr. 4)

Komuna e Mitrovicës

Gjithsej janë testuar 698 mostra, jashtë standardeve kanë rezultua 16 mostra apo 3.0 %.

R1- janë testuar 532 mostra, jashtë standardeve kanë rezultua 15 mostra apo 1.36 %.

R2- janë testuar 172 mostra jashtë standardeve kanë rezultua 11 mostra apo 6.02%.

R3- janë testuar 12 mostra dhe që të gjitha kanë rezultuar brenda standardit për ujin për pije.

Tabela 2 Raporti vjetor për monitorim extern të ujësjellësve të Regjionit të Mitrovicës për vitin 2022

	Mitrovica	
Rutina	Të realizuar a	Jashtë standardi t
R1	532	15
R2	179	11
R3	12	0
TOTALI	698	16

Tabela 3 Monitorimi i cilesisë së ujit për pije në Regjionin e Mitrovices/viti 2022

	Te realizuara	Jashtë standardi t	%
R1	904	15	1.65
R2	303	40	3.3
R3	16	0	0
TOTALI	1223	55	1.65

Tabela 4. Monitorimi i cilesisë së ujit per pije KRU"Mitrovica" me kontratë/viti 2022

	Te realizuara	Jashtë standardi t	%
R1	232	0	0
R2	124	17	13.70
TOTALI	356	17	4.77

GJENDJA E PELLGUT LUMOR- IBËR

Lumi Ibër ndodhet në basenin e lumit Drenica dhe në Luginën e Kosovës dhe shërben për rreth 1.053.000 banorë.¹⁰ Ai është një nga katër pellgjet lumore në Kosovë, ku baza e lumit Ibër buron nga gjashtë burime në malet e Malit të Zi, rrjedh në territorin e Malit të Zi dhe Serbisë dhe hynë në territorin e Kosovës pranë vendbanimit Banja. Më pas rrjedh në juglindje, merr një kthesë të mprehtë majtas dhe kthehet në Mitrovicë. Nga aty, rrjedh në veri nëpërmjet Zveçanit, Leposaviqit dhe Leshakut. Afër Rudnicës, nën majat e Maleve të Kopaonikut, kalon nga territori i Kosovës në Serbi, ku bashkohet me lumin Morava dhe në fund rrjedh në Danub dhe bashkohet me të në Detin e Zi. Lumi Ibër ka një gjatësi prej më shumë se 270 km nga burimi deri në rrjedhjen e tij në lumin Morava perëndimore, me 90 km të kësaj gjatësie të vendosura në territorin e Kosovës. Hapsira totale e kapërcimit të tij në Kosovë mbulon 4.044 km², duke mbuluar 37% të territorit të vendit.




Figura 3 Pellgu lumor Ibër me nën-pellgjet e tjera

¹⁰ SKAT- Raporti Summary Ibër Basin Pressures and Status Shtator 2023

Në pellgun e lumit Ibër janë identifikuar në total 16 nën-baza, që përfshijnë 37 trupa ujëra të sipërm (lume dhe liqene):

26 trupa të ujërave natyral.

10 Trupa të Ujërave të Modifikuar

1 Trup i Ujit Artificial.

Një trup uji artificial është kanali kryesor i ujit irigacionit: Kanali Ibër - Lepenc.

Në bazen e lumin Ibër nuk ka liqene natyrale, por ka 4 liqene që përdoren për ujët të pijes, ujitjen, prodhimin e energjisë dhe për rekreacion.

Cilësia Ekologjike

Në kuadër të projektit “Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë- MIRU” për të vlerësuar gjendjen ekologjike të trupave të ujërave të sipërme, është zhvilluar një hulumtim i monitorimit të cilësisë së ujërave. Gjatë këtij hulumtimi u përdoren elementët e cilësisë biologjike si fitoplanktoni, peshqit, dhe bimët dhe fauna bregdetare. Në pranverën e vitit 2023, në bazen e lumit Ibër u mblodhën të dhëna nga 18 lokacione të ndryshme.

Tabela më poshtë përmbledh klasifikimin e elementëve të cilësisë biologjike. Për çdo element, gjendja është vlerësuar dhe elementi me klasifikimin më të ulët përcakton gjendjen e përgjithshme të cilësisë biologjike. Në pellgun e lumit Ibër, ka vetëm një trup uhor të klasifikuar **si i mirë**. Dy trupa uhorë kanë një gjendje modeste, ndërsa të tjerët janë klasifikuar si **të dobët ose të keqe**.

				Bimët makro-invertebrale bregdetare	Peshku	Diatoms	"Gjendja bazuar në elementin e klasifikuar më të ulët."
Ibër - 02	XK-02-16-02	RV02_011	Ibri - Kushtovë	M	-	G	M
Ibër - 03	XK-02-16-04	RV02_012	Ibri Mitrovicë	P	B	M	B
Ibër - 04	XK-02-16-05	RV02_013	Ibri - Kelmend	P	DD	P	P
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	RV02_021	Sitnica - Bablak	P	B	P	B
Sitnica - 04	XK-02-01-06	RV02_024	Sitnica - Plemetin	B	B	P	B
Sitnica - 05	XK-02-01-07	RV02_025	Sitnica - Nedakocv	P	DD	M	P
Sitnica - 06	XK-02-01-08	RV02_026	Sitnica - Mitrovicë	P	DD	P	P
Llapi - 01	XK-02-10-01	RV02_031	Llapi - Murgullë	G	G	G	G
Llapi - 03	XK-02-10-03	RV02_033	Llapi - Milloshevë	P	M	M	P
Sitnica - 04	XK-02-01-06	RV02_041	Prishtina - Bresje	B	B	B	B
Gracanka - 02	XK-02-04-03	RV02_051	Graqanka - Vragoli	B	B	B	B
Drenica - 01	XK-02-07-01	RV02_061	Drenica - Pjetërshicë	M	DD	G	M
Sitnica - 03	XK-02-01-05	RV03_062	Drenica - Vragoli	P	P	M	P
Shtimje - 01	XK-02-01-01	RV02_071	Shtimje - Devetak	M	DD	M	M
Shtimje - 02	XK-02-01-02	RV02_072	Shtimje - Muzeqinë	P	DD	P	P
Reservoir	XK-02-08-03		Batlava	M	M	M	M
Reservoir	XK-02-16-01		Ujmani	M	DD	G	M
Not assigned to SB			Drenica - Krojmir	P	B	G	B

G- Good	M-Moderate	P-Poor	B-Bad
---------	------------	--------	-------

Tabela 5. Ndotja e ujërave në bazë të parametrave ekologjik

Ibri (XK-02-16-02): Ne kete zone, ka bime makro-invertebrale bregdetare dhe algave diatoms. Gjendja e ujit eshte klasifikuar si "M," (moderate) por nuk ka informacion rreth pranise se peshkut.

Ibri Mitrovicë (XK-02-16-04): Ne kete zone, ka bime makro-invertebrale bregdetare, peshk, dhe algave diatoms. Gjendja e ujit eshte klasifikuar si "B."(bad)

Ibri - Kelmend (XK-02-16-05): Ne kete zonë, ka bime makro-invertebrale bregdetare, peshk, dhe algave diatoms. Gjendja e ujit eshte klasifikuar si "P." (Poor)

Prania e bimëve makro-invertebrale bregdetare në keto vende tregon për ekosisteme ujore të ndryshme, ndërsa prania e algave diatoms dhe peshkut sugjeron një diversitet të mëtjeshëm në biodiversitetin e këtyre vendeve. Gjendja e ujit, e cilësuar me elementin e klasifikuar më të ulët, është raportuar të ndryshme, që sugjeron variabilitet në cilësinë e ujit në keto vende.

SB	SB Code	Monitoring Station Code	Monitoring station	Oksigjeni i tretur (TO) mg/l	Kërkesa Biokimike për Oksigjen (BOD5) mg/l	Ammonium (NH4) mg N/l	Nitrate (NO3) mg N/l	Total Nitrogen mg N/l	Orthophosphate (PO4) mg P/l	Total Phosphorus mg P/l	Conductivity (EC) uS/cm	Gjenbazuarelemente klasifikim të
lbër - 01	XK-02-16-01	RV02_011	Kushtove	8.47	2.98	0.65	0.25	1,11	0.05	0,16	298	M
lbër - 02	XK-02-16-02	RV02_012	Mitrovicë	9.14	17.46	0.90	0.40	2,62	0.11	0,70	341	P
lbër - 03	XK-02-16-04	RV02_013	Klemend	7.87	19.59	1.56	1.28	4,67	0.20	0,81	478	B

Tabela 6. Klasifikimi i gjendjes së lumenjëvë në bazë të elementeve kimike gjenerale

Bazuar në të dhënat e siguruar për stacionet e ndryshme të monitorimit dhe parametrat e cilësisë së ujit të tyre, mund të nxjerrim përfundimet:

Oksigjeni i Tretur (TO): Niveli i oksigjenit të tretur në lumin e Ibrit ndryshon ndjeshëm në mes stacioneve të monitorimit. Stacioni RV02_011 në Kushtovë ka nivele të mira të DO (8.47 mg/l), treguese të shëndetshme të oksigjenit. Megjithatë, Stacioni RV02_012 në Mitrovicë dhe Stacioni RV02_013 në Klemend kanë nivele më të ulëta. Këto nivele të ulëta të DO mund të jenë tregues të ndotjes ose zvogëlimit të cilësisë së ujit.

Kërkesa Biokimike për Oksigjen (BOD5): Nivelet e BOD5 te Stacioni RV02_011 në Kushtovë janë të ulëta tregues i një niveli të ulët të ndotjes organike. Megjithatë, Stacionet RV02_012 në Mitrovicë dhe RV02_013 në Klemend kanë nivele shumë më të larta të BOD5.

Këto nivele të larta tregojnë për ndotje të lartë organike, me shumë gjasa nga burime antropogjene.

Nivelet e Ushqyerjes ujore: Nivelet e ushqimit, përfshirë amonin (NH₄), nitrat (NO₃), azotin total, ortofosfatat (PO₄), dhe fosforin total janë të larta në të gjitha stacionet e monitorimit. Këto nivele të larta mund të çojnë në eutrofikim të ujërave dhe ndikime negative në ekosistemin ujqor.

Konduktiviteti (EC): Nivelet e konduktivitetit janë më të larta te Stacioni RV02_013 në Klemend, tregues i niveleve më të larta të kripës dhe joneve të tretura në ujë, me mundësi që të jenë nga rrjedhat bujqësore ose burimet industriale.

SB	SB Code	SB Form	Monitoring Station Code	Monitoring station	Sub-Basin	Kromi (Cr) µg/l	Zinku (Zn) µg/l	Mangani (Mn) µg/l	Baker (Cu) µg/l	Hekur(Fe) µg/l	Statuti I lumit
lbër - 01	XK-02-16-01	HMËB			XK-02-16						
lbër - 02	XK-02-16-02	Natural	RV02_011	Kushtove		25	7	74	17	71	G
lbër - 03	XK-02-16-04	HMËB	RV02_012	Mitrovicë		58	13	77	10	80	M
lbër - 04	XK-02-16-05	Natural	RV02_013	Klemend		66	387	276	181	126	M

Tabela 7. Ndotësit e veqantë- metalet e rënda

Metalet e Rënda: Nivelet e metaleve të rënda, si kromi (Cr), zinku (Zn), manganezi (Mn), bakri (Cu), dhe hekuri (Fe), ndryshojnë ndjeshëm midis stacioneve të monitorimit dhe SËB-të. Disa prej këtyre metaleve tregojnë nivele të larta, sidomos te stacioni RV02_013 në Kelmend, ku disa metale janë në nivelet më të larta.

Statusi i Trupave të Ujit: Statusi i trupit të ujit është i klasifikuar në mënyrë të ndryshme për secilin SB. Stacioni RV02_011 në Koshtovë është klasifikuar si "G" (i mirë), stacioni RV02_012 në Mitrovicë është klasifikuar si "M" (i mesëm), ndërsa stacioni RV02_013 në Kelmend gjithashtu është klasifikuar si "M" (i mesëm).

SB	SB Code	SËB Form	Monitoring Station Code	Monitoring station	EU code	Cad- mium (Cd) µg/l	Nickel (Ni) µg/l	Plumbi (Pb) µg/l	Statusi I lumit
lbër - 01	XK-02-16-01	HMËB			5				
lbër - 02	XK-02-16-02	Natural	RV02_011	Kushtove	5	15.01	44	2.3	F
lbër - 03	XK-02-16-04	HMËB	RV02_012	Mitrovicë	5	19.39	68	4.1	F
lbër - 04	XK-02-16-05	Natural	RV02_013	Klemend	5	9.51	82	209.4	F
Kanali lbër - Lepenec	XK-02-17-01	AËB			5				

Tabela 8. Substancat tjera (Cd, Ni dhe Pb)

F- Fail to achieve

Në tabelën e cilësisë së ujit në trupat e ujit të sipërme (SB) për disa stacione të monitorimit dhe kanalin lbër - Lepenec, vërehen vlerat e metaleve të rënda, si kadmiu (Cd), nikeli (Ni) dhe plumbi (Pb), dhe statusi i trupit të ujit. Në këtë rast, të gjitha trupat e ujit janë klasifikuar si "F" (Fail), që tregon një cilësi të dobët të ujit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ∅ Republika e Kosovës ka arritur një **progres të madh në miratimin e legjislacionit modern në fushën e ujërave**. Shtysë e këtij procesi ka qenë përpjekja për ta përafuar *acquis* të BE-së duke pasur parasysh aspiratat e vendit për integrim në BE dhe është i përshtatshëm për të u avancuar më tutje por që legjislacioni plotëson mjaftueshëm bazën për mbrojtje të ujërave. Vështirësitë kryesore janë në implementimin e tyre.
- ∅ Edhe pse mungojnë të dhëna të plota për vlerësimin e statusit të ujërave sa i përket cilësisë, nga matjet ekzistuese mund të konstatohet lehtë se **gjendja e lumenjve është përgjithësisht e keqe** – përpos në zonat malore në rrjedhën e sipërme mbi vendbanime ku cilësia është shumë e mirë. Shkaktarët kryesorë të ndotjes së lumenjve janë shkarkimi i ujërave të patrajuara të kanalizimit, shkarkimi i ujërave të ndotura industriale, hudhja e mbeturineve, kullimi i materieve ndotëse nga tokat bujqësore.
- ∅ Monitorimi i Vazhdueshëm- Në Kosovë e sidomos në Mitrovicë mungon një monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave, ky monitorim do të ndihmonte në përcaktimin e ndonjë ndryshimi në cilësi dhe identifikimin e problemeve të reja dhe parandalimin e situatave alarmante për cilësi të ujërave
- ∅ Hulumtime shkencore dhe analiza të detajizuara- Duhet të realizohen hulumtime të thella për të identifikuar burimet e ndotjes së metaleve të rënda dhe lëndëve të tjera të ndotjes. Kjo mund të përfshijë analiza të mëtejshme të substancave kimike me studentë apo profesionistë të ndryshëm të fushës së kimisë.
- ∅ Ngritje e vetëdijes- Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut në Mitrovicë për të informuar komunitetin në lidhje me ndotjen e ujërave dhe rreziqet e që paraqiten për shëndetin dhe mjedisin. Preferohen të përdoren rrjetet sociale dhe kanalet e tjera të komunikimit, takimet dhe materialet informuese.
- ∅ Bashkëpunimi në mes institucioneve qendrore dhe lokale si dhe bashkëpunim regjional. Duhet të nxitet një bashkëpunim konkret në mes të institucioneve qendrore dhe atyre lokale, organizatave të tjera që merren me cilësinë e ujërave, IKSHP dhe qytetarët që të jenë sa më të informuar mbi gjendjen e ujërave në vendin e tyre.
- ∅ Krijimi i një platforme për shpërndarjen e informatave në formë vizuale mund të jetë një mjet i lehtë për të u krijuar dhe të përdoret nga shumë aktorë për avancimin e informimit mbi gjendjen e ujit dhe lumenjëve.
- ∅ Mbrojtja e Resurseve ujore nga niveli qendror dhe lokale- Kërkohej një definim i kompetencave dhe një angazhim i gjithë anshëm për të mbrojtur resurset ujore, shtimi i numrit të inspektorëve komunal dhe avancimi i përdorimit të teknologjive në identifikimin e ndotësve dhe iniciimi i gjobave në bazë të parimit “ndotësi paguan”.